

PHILIPS

AVENT

SCD501

SCD502

SCD503




Manuali i përdorimit


1 Përmbajtja

Hyrje.....	4
E rëndësishme	4
Përmbledhje e produktit	7
Përgatitja për përdorim	7
Njësia e foshnjës	7
Njësia e prindit	7
Përdorimi i monitorit të foshnjës.....	9
Pozicionimi i monitorit të foshnjës	9
Lidhja e njësisë së prindit me njësinë e foshnjës.....	9
Funksionet.....	11
Modaliteti "Smart Eco"	11
Njësia e foshnjës	11
Njësia e prindit	11
Pastrimi dhe mirëmbajtja	12
Vendruajtja	12
Porositja e aksesorëve	12
Garancia dhe mbështetja	13
Mjedisi	13
Pyetjet e shpeshta	13

A



B



1 Hyrje

Urime për blerjen dhe mirë se vini pranë "Philips AVENT"! Për të përfituar plotësisht nga mbështetja që ofron "Philips AVENT", regjistroni produktin në faqen www.philips.com/welcome. Lexojeni këtë manual me kujdes.

2 E rëndësishme

Rrezik

- Mos zhysni kurrë asnjë pjesë të monitorit të foshnjës në ujë apo në lëngje të tjera. Mos e vendosni aty ku mund të pikohet apo laget nga uji apo lëngje të tjera. Mos e përdorni në vende me lagështisë apo pranë ujit.
- Mos vendosni asgjë mbi monitorin e foshnjës dhe mos e mbulonit atë. Mos ia bllokoni vrimat e mundshme të ajrimit.
- Kordonët përbëjnë rrezik mbyetjeje. Mbajini kordonët larg fëmijëve (mbi 1 metër/3,5 këmbë larg). Mos e vendosni kurrë aparatit e foshnjës brenda shtratit apo këndit të foshnjës.



Paralajmërim

- Përpara se ta lidhni pajisjen kontrolloni nëse tensioni i treguar në ushqyesit e aparatit të foshnjës dhe aparatit të prindit përkon me tensionin e rrjetit elektrik.
- Përdorni vetëm ushqyes të rekomanduar nga "Philips" (modeli S003Axy0600050 (ku "xy" = TV, TB në varësi të llojit të spinës)
Vlerat nominale të ushqyesit:
Hyrja 100-240 V ~ 50/60 Hz,
0.15 A Dalja: 6.0 V = 0.5 A,
3 W Efikasiteti aktiv mesatar:
74.38% Konsumi i energjisë pa ngarkesë (W): 0.1 W NIVELI VI).
- Konsumi i energjisë në modalitetin e fikur: Njësia e foshnjës: <0.3 W. Njësia e prindit: <0,3 W (< 1 min).
- Mos i modifikoni dhe/apo prisni dhe/apo ndryshoni pjesët e ushqyesit, pasi kjo shkakton situatë të rrezikshme.
- Mos e përdorni monitorin e foshnjës nëse ushqyesi i njësive së foshnjës ose prindit është i dëmtuar. Kontaktoni me qendrën e shërbimit të klientit të "Philips".
- Mos e zhvendosni panelin e pasmë të aparatit të fëmijës për të parandaluar elektroshokun.

- Kjo pajisje nuk synohet të përdoret nga persona (duke përfshirë fëmijët) me aftësi të kufizuara fizike, ndijore ose mendore, ose me mungesë përvoja dhe njohurish, përveç nëse mbikëqyren apo udhëzohen për përdorimin e pajisjes nga një person përgjegjës për sigurinë e tyre. Fëmijët nuk duhet të luajnë me pajisjen.

Kujdes

- Ky monitor foshnje synohet për përdorim ndihmës. Mos e përdorni si zëvendësues të mbikëqyrjes së duhur dhe të përgjegjshme nga i rrituri.
- Përdoreni pajisjen në temperaturë midis 0 °C dhe 40 °C. Ruajeni pajisjen në temperaturë midis -25 °C dhe 70 °C.
- Mos e ekspozoni njësinë e bebes dhe njësinë e prindit ndaj ftohtësisë ose nxehtësisë ekstreme ose ndaj dritës së drejtpërdrejtë të diellit. Mos e vendosni njësinë e bebes dhe njësinë e prindit pranë një burimi nxehtësie.
- Mos e mbuloni asnjëherë njësinë e prindit dhe të foshnjës me asgjë (p.sh. me pecetë ose batanije).

- Vendosni gjithmonë bateri të llojit të duhur në njësinë e prindit (shihni "Vendosja e baterive" në kapitullin "Përgatitja për përdorim").
- Nëse e vendosni njësinë e prindit ose të fëmijës pranë një transmetuesi ose një pajisjeje tjetër DECT (p.sh. telefon DECT ose rrugëzues me valë për internet), lidhja mund të shkëputet. Lëvizeni njësinë e foshnjës ose të prindit më larg pajisjeve të tjera me valë derisa të rikthehet lidhja.
- Celularët e ndezur në afërsi të monitorit të foshnjës mund të shkaktojnë interferencë me monitorin e foshnjës.

Informacion i rëndësishëm për bateritë

- Vendosni gjithnjë bateri të tipit të duhur në aparatin e prindit për të evituar rrezikun e shpërthimit.
- Aparati i prindit nuk ka funksion karikimi. Nëse përdorni bateri të karikueshme në njësinë e prindit, karikojini ato në një karikues baterish.
- Sigurohuni që t'i keni duart të thata kur futni apo ndërroni bateritë.
- Për të evituar pikimin, dëmtimin apo shpërthimin e baterive:

- 1 Mos e ekspozoni pajisjen ndaj temperaturave më të larta se 40 °C. Bateritë mund të shpërthejnë nëse ekspozohen ndaj diellit, zjarrit ose temperaturave të larta.
 - 2 Mos i mbingarkoni, shkaktoni qark të shkurtër, karikoni në pole të kundërta apo dëmtoni bateritë.
 - 3 Hiqini bateritë nga njësia e prindit nëse nuk do ta përdorni pajisjen për një muaj ose më shumë.
 - 4 Mos lini bateri të shkarkuara në njësine e prindit.
- Asgjësojini siç duhet bateritë e jo të karikueshme dhe ato të karikueshme (shihni kapitullin "Mjedisi").
 - Për të mbrojtur lëkurën tuaj, vishni doreza mbrojtëse kur administroni bateri të dëmtuara ose që pikojnë.
 - Për të pasur një kohë funksionimi pa kordon deri në 24 orë, futni bateri me një kapacitet prej 1500 mAh ose më shumë në njësine e prindit.

Pajtueshmëria me standardet

- Kjo pajisje është në përputhje me të gjitha standardet dhe rregulloret në fuqi për ekspozimin ndaj fushave elektromagnetike.
- Kjo pajisje është në përputhje me kërkesat e radiointerferencës të Komunitetit Evropian.



- Nëpërmjet këtij dokumenti, "Philips Consumer Lifestyle, Tussendiepen 4, Drachten, Netherlands" deklaron se ky monitor për foshnja është në përputhje me kërkesat thelbësore dhe dispozita të tjera përkatëse të Direktivës 2014/53/BE (DECT: banda e frekuencës 1880-1900 MHz, fuqi maksimale e radiofrekuencës: 250 mW). Një kopje e deklaratës së konformitetit KE (DoC) ofrohet në internet në **www.philips.com/support**.

3 Përmbledhje e produktit

A Njësia e prindit

- 1 Dritat e nivelit të zërit
- 2 Butoni i ndezjes/fikjes 
- 3 Butoni i volumit -
- 4 drita "link"
- 5 Foleja për fishën e vogël të ushqyesit
- 6 Drita e baterisë
- 7 Butoni i volumit +
- 8 Butoni i lëshimit të kapakut të folesë së baterisë
- 9 Kapaku i folesë së baterisë
- 10 Ushqyesi

B Njësia e foshnjës


- 1 Butoni i dritës së natës
- 2 Butoni i ndezjes/fikjes 
- 3 Drita e ndezjes
- 4 Kordoni fiks i rrjetit
- 5 Ushqyesi

4 Përgatitja për përdorim

Njësia e foshnjës

Aparati i foshnjës punon me linjën elektrike dhe ka kordon fiks elektrik.

- 1 Vendoseni ushqyesin në e kordonit elektrik në prizë për ta lidhur njësinë e foshnjës me rrjetin kryesor.




Njësia e prindit

Aparati i prindit funksionon me linjën elektrike. Mund dhe të futni bateri për të lejuar përdorimin portativ të aparatit të prindit.

Funksioni i rrjetit kryesor

- 1 Futni fishën e vogël në prizë në panelin anësor të njësise së prindit dhe futni ushqyesin në prizë.



Vendosja e baterive

Nëse njësia e prindit nuk është pranë prizës, mund ta përdorni në dy bateri të jo të karikueshme alkaline 1,5 V R6 AA ose dy bateri të karikueshme AA 1,2V R6 AA (nuk ofrohen). Koha e funksionimit me bateri të karikuara plotësisht është deri në 24 orë, në varësi të llojit të baterive të përdorura dhe sa gjatë dhe sa shpesh e përdorni njësine e prindit me bateri.


Shënim:

Vini re se njësia e prindit nuk i karikon bateritë kur është e lidhur me rrjetin kryesor. Mund të përdorni bateri të karikueshme në njësine e prindit, por duhet t'i karikoni ato në një karikues të veçantë.


Paralajmërim:

Hiqni nga priza njësine e prindit dhe sigurohuni që duart tuaja, si dhe njësia të jenë të thata kur të futni bateritë.

- 1** Shtypni butonin e lëshimit (1) për të shkyçur dhe për të hequr kapakun e folesë së baterive (2).




- 2** Futni bateritë jo të karikueshme ose bateri të karikueshme të karikuara plotësisht.



Shënim:

Sigurohuni që polet + dhe - të baterive të jenë në drejtimin e duhur.

- 3** Për të rivendosur kapakun e folesë së baterive, fillimisht fusni gjuhëzën në buzën e poshtme të folesë së baterisë. Më pas shtypni kapakun derisa të kyçet në vend me një kërcitje.




5 Përdorimi i monitorit të foshnjës

Pozicionimi i monitorit të foshnjës


⚠ Paralajmërim:

Mbajeni aparatën e foshnjës jashtë vendeve ku mund të arrihet nga foshnja. Mos e vendosni kurrë aparatën e foshnjës brenda shtratit apo këndit të foshnjës.

- Për shkak se kordoni i njësisë së foshnjës përbën një rrezik të mundshëm për mbytje, sigurohuni që njësia e foshnjës dhe kordoni i saj të jenë të paktën 1 metër/3,5 këmbë larg foshnjës.




- Për të parandaluar një tingull me ton të lartë nga një ose të dyja njësitë, sigurohuni që njësia e prindit të jetë të paktën 1,5 metra/4,9 këmbë larg njësive së foshnjës.




Lidhja e njësive së prindit me njësine e foshnjës


- 1 Shtypni dhe mbani shtypur butonin në njësine e foshnjës  për 3 sekonda derisa të ndizet drita e ndezjes.




- 2 Shtypni dhe mbani shtypur butonin në njësine e prindit për 3 sekonda derisa drita "link" të fillojë të pulsojë në ngjyrë të kuqe.



- Kur njësia e prindit dhe njësia e foshnjës janë të lidhura, drita "link" bëhet jeshile e qëndrueshme.*



- Nëse nuk krijohet lidhja, drita "link" do të vazhdojë të pulsojë në ngjyrë të kuqe dhe njësia e prindit do të lëshojë tinguj.



Çfarë duhet bërë nëse nuk arrihet lidhja

- Nëse aparati i prindit është jashtë rrezes, vendoseni më pranë aparatis të foshnjës.
- Nëse aparati i foshnjës ose aparati i prindit është shumë afër një pajisjeje tjetër DECT (p.sh. telefon me valë), fikenit këtë pajisje ose largojeni aparatin nga kjo pajisje.
- Nëse njësia e foshnjës është e fikur, ndizeni atë.

Rrezja e funksionimit

- Rrezja e funksionimit është deri në 300 metra/985 këmbë në ambient të hapur dhe deri në 50 metra/150 këmbë në ambient të mbyllur.
- Rrezja e funksionimit të monitorit të foshnjës ndryshon në varësi të ambientit përreth dhe faktorëve që mund të shkaktojnë dobësim të sinjalit. Materialet e lagura dhe të njoma mund të shkaktojnë interferencë të atillë që dobësimi i sinjalit të jetë deri në 100%. Për dobësimin e sinjalit nga materialet e thata, shihni tabelën më poshtë.

Materiale të thata	Trashësia e materialeve	Humbja e rrezes
Dru, suva, karton, xham (pa metal, tela apo plumb)	< 30 cm (12 in)	0-10%
Tullë, kompensatë	< 30 cm (12 in)	5-35%
Beton arme	< 30 cm (12 in)	30-100%
Rrjeta ose shufra metalike	< 1 cm (0,4 in)	90-100%
Fletë metalike ose alumini	< 1 cm (0,4 in)	100%

6 FunkSIONET

Modaliteti "Smart Eco"


Ky monitor foshnjash ka modalitete "Smart Eco" si funksion standard. Ky modalitet është gjithmonë aktiv dhe redukton automatikisht sinjalin DECT nga njësia e foshnjës në njësinë e prindit për të kursyer energji dhe për të reduktuar radiotransmetimin.

Njësia e foshnjës

6.2.1 Drita e natës

Drita e natës lëshon një ndriçim të butë për qetësimin e foshnjës.


- 1 Shtypni butonin e dritës së natës në krye të njësisë së foshnjës për të ndezur ose për ta fikur dritën e natës.



Njësia e prindit

Drita e baterisë


- 1 Drita e baterisë fiket kur njësia e prindit është e lidhur me rrjetin ose kur bateritë kanë energji të mjaftueshme.
- 2 Kur bateritë janë në nivel të ulët, drita e baterisë ndizet në ngjyrë të kuqe dhe njësia e prindit lëshon tinguj.



- 3 Ndërrojini bateritë kur janë në nivel të ulët (shihni "Vendosja e baterive" në kapitullin "Përgatitja për përdorim").


Caktimi i volumit

- 1 Shtypni butonin + për të rritur volumnin.



- Dëgjoni një tingull sa herë që shtypni butonin për të rritur ose për të ulur volumnin me një nivel.
- Dritat e nivelit të zërit ndizen shkurtimisht për të treguar volumnin aktual.

- 2** Shtypni butonin - për të ulur volumin. Nëse mbani të shtypur butonin - për 2 sekonda, e caktoni volumin në heshtje.



Shënim:

Nëse volumi caktohet në heshtje, dritat e nivelit të zërit tregojnë se foshnja po lëshon tinguj. Sa më i lartë të jetë zëri i tingujve që lëshon foshnja, aq më shumë drita të nivelit të zërit ndizen.

7 Pastrimi dhe mirëmbajtja

- Mos përdorni spërkatëse apo solucone të lëngëta pastrimi.
- Hiqini nga priza aparatin e prindit dhe të foshnjës përpara pastrimit.
- Pastrojini aparatin e prindit, aparatin e foshnjës dhe ushqyesit me një leckë të thatë.

8 Vendruajtja

- Hiqini bateritë nga aparati i prindit nëse nuk e përdorni për më shumë se një muaj.
- Ruajini aparatin e prindit, ushqyesin dhe aparatin e foshnjës në një vend të freskët dhe të thatë.

9 Porositja e aksesoreve

Për të blerë aksesore ose pjesë ndërrimi, vizitoni **www.shop.philips.com/service** ose shkoni te shitësi i "Philips". Gjithashtu mund të kontaktoni me Qendrën e Kujdesit për Klientin të "Philips" në vendin tuaj (shihni fletëpalosjen e garancisë në mbarë botën për të dhënat e kontaktit).

10 Garancia dhe mbështetja

Nëse ju duhet informacion ose mbështetje, vizitoni www.philips.com/support faqen e interneti të "Philips" në ose lexoni fletëpalosjen e veçantë të garancisë ndërkombëtare.

11 Mjedisi

- Ky simbol do të thotë që nuk duhet ta hidhni pajisjen me mbeturinat normale shtëpiake. Hidhni pajisjen në një pikë zyrtare grumbullimi për pajisjet elektrike. Asgjësimi i saktë ndihmon në ruajtjen e mjedisit.



- Ky kosh me rrota me kryq do të thotë që pajisja përmban bateri njëpërdorimëshe që nuk duhet të hidhen me mbeturinat normale shtëpiake. Hidhni bateritë në një pikë zyrtare grumbullimi për bateritë. Asgjësimi i saktë i baterive ndihmon në ruajtjen e mjedisit.



12 Pyetjet e shpeshta

Pse nuk ndizet drita e ndezjes e njësisë së foshnjës dhe drita "link" e njësisë së prindit kur shtyp butonat e ndezjes/fikjes të njësisë?

- Ndoshta një ose të dyja njësitë nuk janë futur siç duhet në prizë. Lidhni njësitë në rrjetet kryesore dhe shtypni butonat e ndezjes/fikjes në të dyja njësitë për 3 sekonda për të krijuar lidhjen midis njësisë së prindit dhe asaj të foshnjës.
- Nëse e përdorni njësinë e prindit me bateri, bateritë e njësisë së prindit janë të shkarkuara ose nëse nuk ka bateri në fole.

Pse pulson vazhdimisht në ngjyrë të kuqe drita "link" e njësisë së prindit?

- Njësia e foshnjës është jashtë rrezes së njësisë së prindit. Zhvendoseni njësinë e prindit më pranë njësisë së foshnjës.
- Njësia e foshnjës mund të jetë e fukur. Ndizeni njësinë e foshnjës.

Përse tingëllon njësia e prindit?

- Njësia e foshnjës mund të jetë e fukur. Ndizeni njësinë e foshnjës.
- Nëse njësia e prindit lëshon tinguj ndërkohë që drita "link" pulson vazhdimisht në ngjyrë të kuqe, lidhja me njësinë e foshnjës është shkëputur. Zhvendoseni njësinë e prindit më pranë njësisë së foshnjës ose ndizni njësinë e foshnjës nëse ishte e fukur.

Pse lëshon zhurmë me ton të lartë pajisja?

Njësitë mund të jenë shumë pranë njëra-tjetrës. Sigurohuni që njësia e prindit dhe ajo e foshnjës të jenë të paktën 1 metër/3,5 këmbë larg njëra-tjetrës.

Pse nuk dëgjoj tinguj/Pse nuk i dëgjoj të qarat e foshnjës?

- Njësia e foshnjës mund të jetë jashtë rrezes së njësise së prindit. Reduktoni distancën midis njësive.
- Mund ta keni caktuar volumin në nivelin më të ulët (heshtje). Risni volumin.

Pse reagon shumë shpejt njësia e prindit ndaj tingujve të tjerë?

- Njësia e foshnjës kap dhe zëra të ndryshëm nga ato të foshnjës. Lëvizeni njësinë e foshnjës më pranë foshnjës (por gjithnjë duke mbajtur distancën minimale prej 1 metri/3,5 këmbë).

Rrezja e specifikuar e funksionimit të monitorit të foshnjës është 300 metra/985 këmbë. Pse monitori im i foshnjës punon vetëm në distancë shumë më të shkurtër se kaq?

- Rrezja e specifikuar është e vlefshme vetëm në ambient të hapur. Brenda shtëpisë suaj, rrezja e funksionimit është e kufizuar nga numri dhe lloji i mureve dhe/ose tavanëve të shtëpisë. Brenda shtëpisë, rrezja e funksionimit është deri në 50 metra/150 këmbë.

Pse shkëputet lidhja ose ka ndërprerje të herëpashershme të zërit?

- Njësia e foshnjës dhe njësia e prindit mund të jenë pranë kufijve të rrezes së funksionimit. Provoni një vendndodhje tjetër ose pakësoni distancën midis njësive. Kini parasysh se duhen rreth 30 sekonda çdo herë para krijimit të lidhjes ndërmjet njësive.
- Mund ta keni vendosur njësinë pranë një transmetuesi ose një pajisjeje tjetër DECT, si p.sh. një telefon DECT ose monitor tjetër foshnjash 1,8 GHz/1,9 GHz. Zhvendoseni njësinë larg pajisjeve të tjera derisa të rikthehet lidhja.

A është i sigurt monitori im i foshnjës nga përgjimi dhe interferenca?

- Teknologjia DECT e këtij monitori foshnjash garanton që nuk do të ketë asnjë interferencë nga pajisje të tjera, dhe as përgjim.

Pse shkarkohen shpejt bateritë e njësise së prindit kur e përdor njësinë me bateri?

- Koha e funksionimit me bateri mund të jetë deri në 24 orë, por kjo varet nga lloji i baterive të përdorura dhe sa shpesh dhe sa gjatë e përdorni njësinë e prindit me bateri. Vini re se bateritë nuk karikohen kur njësia e prindit është e lidhur me rrjetin kryesor. Futeni njësinë e prindit në prizë kur kjo e fundit disponohet në afërsi për të kursyer energjinë e baterisë.
- Sigurohuni që të përdorni bateri jo të karikueshme alkaline 1,5V R6 AA ose bateri të karikueshme 1,2V R6 AA të karikuara. Karikoni bateritë e rikarikueshme në një karikues të veçantë për bateri.

A mund ta përdor njësinë e foshnjës me bateri?

- Jo, njësia e foshnjës nuk mund të përdoret me bateri. Njësia e foshnjës mund të përdoret vetëm me rrjetin kryesor.

